



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:232374
Datë: 28.10.2024
Numri i dokumentit: 06362249

PPP.nr.168/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në përbërje me gjyqtarin Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike të kreditorit A. S. nga P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. Islamil Selimi, kundër debitorit Trepça Sh.A, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Arianit Voca, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seancës gjyqësore me datë 28.10.2024 nxjerr ketë:

A K T V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si i pabazuar prapësimi i debitorit Trepça Sh.A, i ushtruar kundër urdhërit përmbaues P.nr.... i datës ... mbi lejimin e përmbaimit të propozimit për përmbaimit të datës ..., të kreditorit A. S. nga P.,
- II. **LIHET** në fuqi urdhërit përmbaimitor mbi lejimin e përmbaimit P.nr.... i datës

Arsyetim

Kreditori, A. S. nga P. me datën ... ka paraqitur propozimin për përmbaimit sipas titullit përmbaimitor – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.... i datës ..., kundër debitorit Trepça Sh.A.

Përmbauesi Privat, me urdhërin përmbaimitor P.nr.... ..., ka lejuar propozimin për përmbaimit të kreditorit Azem Sopjani nga Prishtina.

Kundër këtij urdhëri, debitori në afat ligjor ka paraqitur prapësimin duke i propozuar gjykatës që ta rafuzojë propozimin për përmbaimit për arsye se propozimi për përmbaimit nuk e përmban origjinalin ose kopjen e vërtetuar të dokomuntit përmbaues.

Në bazë të nenit 22 parargafi 1 nënparagrafi 1.1 i Ligjit për Procedurën Përmbaimitore, parashihet “*Dokumente përmbauese janë: vendimi përmbaues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbauese.*”

Në bazë të nenit 23 paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Përmbaimitore, parashihet që “*Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në*

procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësore konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”

Në bazë të nenit 24 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, parashihet që *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*

Në bazë të nenit 27 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore parashihet që *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.*

Gjykata, vlerëson se dokumenti përmbarimor - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.... i datës ..., sipas dispozitave të lartëcekura është i përshtatshëm për përmbarim dhe për këtë arsye edhe refuzojë prapësimin e debitorit, për shkak pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk janë të bazuara dhe titulli përmbarimor është i paraqitur në origjinal.

Gjykata, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, duke iu referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore”*, përjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.

Andaj nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 73 të LPP-së, dhe në bazë të argumentimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
PPP.nr.168/24, me datë 28.10.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.